



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHKETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Konvikti Shtetëror i Studentëve "Tome Stefanovski - Seniç" - Shkup (llogaria e buxhetit themelor).

Lënda e revizionit:

Revizion i pasqyrave financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindja a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabime në të gjitha aspektet materiale

Gjendjet kyçe të identifikuara:

- zbatimi joadekuat i rregulloreve ligjore për mënyrën e llogaritjes dhe pagesës së pagës dhe shtesave të pagave;
- inventarizimi jo i plotë i pasurive dhe detyrimeve;
- parregullsi në zbatimin e normave për përgatitjen e ushqimit për përdoruesit e shërbimeve të Konviktit.

Opinionit i dhënë *:



Shprehet mendim i pafavorshëm për vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare dhe rezultatin e aktiviteteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me legjislacionin përkatës, udhëzimet dhe politikat e përcaktuara për vitin 2019.

Rekomandimet kyçe:

- të ketë qasje drejt rregullimit të vlerës së pikës së pagës në përputhje me aktet ligjore ekzistuese;
- të bëhet inventarizim i plotë të pasurive dhe detyrimeve në përputhje me dispozitat për përfituesit e fondeve nga buxheti i RMV-së;
- përgatitja dhe lëshimi i ushqimit në përputhje me normën dhe menytë e përditshme.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Harmonizimi i dispozitave të Ligj për Standardin e Nxënësve dhe Ligjit për Arsimin e Mesëm me dispozitat e Ligjit për Standardin e Studentëve në fushën e akomodimit të studentëve/nxënësve, kursimin e fondeve dhe funksionimin normal të konvikteve.

Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:

Nga ana e drejtorit të mëparshëm të Konviktit janë pranuar vërejtjet mbi draft raportin e RASH numër 16-382 / 7 të datës 25.03.2021.

Nga ana e personi përgjegjës të Konviktit janë pranuar vërejtje mbi draft raportin e RASH me numër 16-382 / 8 të datës 01.04.2021.

Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

Vërejtjet u shqyrtuan dhe u konkludua se një vërejtje pranohet për shkak të provave shtesë të marra, ndërsa vërejtjet tjera ose paraqesin informim për arsyet e gjendjeve të konstatuara ose nuk pranohen për shkak të mungesës së provave shtesë për të ndryshuar gjendjen e krijuar.

*  pozitive,  me rezervë,  i pafavorshëm,  i përmbajtur